

4.5. NDËRRIMET GRUPORE PËR KONTIMIN E MJETEVE DHE BURIMEVE

Për të mundur të kuptojmë regjistrimin e kontove të veçanta është e nevojshme që së pari të bëhet ndarja (grupimi) i kontove të mjeteve dhe kontove të burimeve. Nisur nga fakti se të gjitha ndërrimet në të cilat lajmërohet ndryshim vetëm në kontot e mjeteve, ndërrim në kontot e burimeve, si dhe ndërrimet në mes të kontove të mjeteve dhe burimeve, mund të ndahen në katër grupe ndërrimesh.

1. Ndërrime, që shkaktojnë rritjen e mjeteve të një kontoje dhe njëkohësisht zvogëlim të një kontoje tjetër mjetesh.



2. Ndërrime, që shkaktojnë rritjen e mjeteve të një kontoje dhe njëkohësisht rritjen e burimeve të një kontoje tjetër.

3. Ndërrime, që shkaktojnë zvogëlimin e mjeteve të një kontoje dhe njëkohësisht zvogëlimin e burimeve të kontos tjetër.

4. Ndërrimet, që shkaktojnë rritjen e burimeve të një kontoje dhe njëkohësisht zvogëlimin e burimeve të kontos tjetër.

Kontimet e rasteve të lartpërmendura do t'i ilustrojmë me anë të shembujve sipas të njëjtës radhitje.

1). Me ndërrimet nga grupi i parë lajmërohet rritja e një mjeti, e cila rritje kontohet në anën e majtë, në anën pozitive të kontos, e hapur për atë mjet. Njëkohësisht lajmërohet zvogëlimi i mjeteve në konton tjetër, e hapur për lloj tjetër mjetesh. Ky zvogëlim paraqet ndërrim negativ dhe regjistrohet në anën e djathtë, në anën negative të kontos. Për këtë lloj ndërrimi mund të shërbehemi me shembullin e tërheqjes së parave nga xhirollogaria për pagesa rrjedhëse nga arka. Le të tërhiqen 10,00 den nga “Xhirollogaria” për nevojat e “Arkës”. Kontimi i këtij ndërrimi bëhet në këtë mënyrë:

| + | | Konto | Arka | - | + | | Konto | Xhirollogaria | - |
|--------------------|-------|-------|---|---|---------------|------------|----------|---|---|
| Gjendja fillestare | 20,00 | | | | Gjendja fill. | (S) 500,00 | Zvogëlim | 10,00 | |
| (Saldoja) S. | | | | | | | | | |
| Rritje | | |  10,00 | | | | |  | |

Prej regjistrimit të kontove mund të konkludohet:

1. Kontoja “**Arka**” në këtë rast korospondon me konton “Xhirollogaria”.

2. Saldoja fillestare e kontos “Arka” është 20.00 den. ndërsa në konton “Xhirollogaria” është 500,00 den.

3. Rriten paratë në K-ton “Arka” për 10,00 den. – ndërim pozitiv

4. Zvogëlohen paratë në K-ton “Xhirollogaria” për 10,00 den.- ndërim negativ.

2). Në grupin e dytë të ndërrimeve vjen deri tek rritja e mjeteve, e cila kontohet në anën e majtë, në anën pozitive të kontos, njëkohësisht lajmërohet K-to burimi i mjeteve , i cili regjistrohet në anën e djathtë të kontos tjetër. Si shembull i këtij lloji ndërimi mund të na shërbejë fitimi (marrja) e kredisë nga banka për 200,00 den. Kredia e marrë kontohet në anën e majtë të K-tos “Xhirollogaria”. Rritja e obligimeve ndaj bankës për kredinë e marrë nënkupton ndryshim negativ dhe regjistrohet në anën e djathtë të K-tos “Kredi për mjete e xhiros”. Ja se si do të regjistrohet ky ndërim në kontot e veçanta:

| + K-to Xhirollogaria - | | + K-to Kredi për mjete e xhiros - | |
|------------------------|--------|-----------------------------------|--------|
| S. | 490,00 | S. | 170,00 |
| Rritja | 200,00 | Rritja | 200,00 |

Nga regjistrimi i lartë i kontove mund të rezimojmë:

1. K-toja Xhirollogaria në këtë ndërim korospondon me K-ton Kredi për mjete e xhiros.

2. Saldoja fillestare para ndërrimit ka qenë në K-to Xhirollogaria 490,00 den. ndërsa në K-ton Kredi për mjete e xhiros ka qenë 170,00 den.

3. Rriten mjete (paratë) në konton “Xhirollogaria” për 200,00 den.- ndërim pozitiv

4. Janë rritur detyrimet (obligimet) për kreditë ndaj K-tos Kredi për mjete e xhiros për 200,00 den.- ndërim negativ.

3).Në grupin e tretë të ndërrimeve vjen deri tek zvogëlimi i një burimi, që regjistrohet në anën e majtë të kontos të burimit adekuat. Njëkohësisht zvogëlohet edhe kontoja e mjeteve që regjistrohet në anën e djathtë të kësaj kontoje. Si shembull mund të na shërbejë pagesa e bërë ndaj furnitorëve, që regjistrohet në anën pozitive të K-tos Detyrime ndaj furnitorëve. Zvogëlimi i

mjeteve monetare për këtë pagesë nënkupton ndërrim negativ në K-ton Xhirollogaria. Ja se si do të pasqyrohet ky ndërrim në kontot përkatëse.

| | |
|------------------------|------------------------------------|
| + K-to Xhirollogaria - | + K-to Detyrime ndaj furnitorëve - |
| S. 690,00 | Zvogëlim 50 |
| ↓ | ↓ |

Nga regjistrimet e më larta mund të konkludojmë:

1. K-toja Xhirollogaria, në këtë rast korospondon me K-ton Detyrime ndaj furnitorëve.
2. Gjendja fillestare në K-ton Xhirollogaria është 690,00 den. ndërsa tek K-toja Detyrime ndaj furnitorëve është 300,00 den.
3. Janë zvogëluar detyrimet ndaj furnitorëve (ndërrim pozitiv) për 50,00 den.
4. Janë zvogëluar mjetet në xhirollogari (ndërrim negativ) për 50,00 den.

4). Në grupin e katërt të ndërrimeve vjen deri tek zvogëlimi i një burimi të një kontoje dhe njëkohësisht rritje e një burimi të një kontos tjetër. Kjo praktikisht nënkupton ndërrim pozitiv të kontos së parë dhe ndërrim negativ të kontos së dytë. Si shembull për këtë grup ndërrimesh mund të na shërbejë dhënia e kambialit të akceptuar furnitorit për 15,00 den. Me këtë zvogëlohen obligimet ndaj furnitorëve (ndërrim pozitiv) dhe rritjen e detyrimeve mujore, që d.m.th. ndërrim negativ në K-ton Kambiali i akceptuar. Ja se si do të pasqyrohet ky ndërrim në kontot përkatëse:

| | |
|------------------------------------|-------------------------------|
| + K-to Detyrime ndaj furnitorëve - | + K-to Kambiali i akceptuar - |
| Zvogëlim 15 | S. 250,00 |
| ↓ | S. 20,00 |
| | Rritje 15,00 |
| | ↑ |

Nga regjistrimet e lartpërmendura mund të konkludojmë:

1. K-toja Detyrimet ndaj furnitorëve në këtë rast korospondon me K-ton Kambiali i akceptuar.
2. Saldoja fillestare e K-tos Detyrimet ndaj furnitorëve është 250,00 den. ndërsa e K-tos Kambiali i akceptuar 20,00 den.
3. Janë zvogëluar Detyrimet ndaj furnitorëve (ndërrim pozitiv) për 15,00 den.

4. Janë rritur Detyrimet ndaj kambialit të akceptuar (ndërim negativ) për 15,00 den.

4.6. HAPJA E KONTOVE NË BAZË TË BILANCIT TË GJENDJES

Në fillim të çdo viti hapen kontot, në të cilën regjistrohen saldot fillestare. Me 31.12. subjektet ekonomike çdo vit përpilojnë bilancin përfundimtar, me çka definohet gjendja përfundimtare e mjeteve dhe burimeve pas regjistrimeve të kryera për çdo ndërrim të bërë gjatë vitit të kaluar. I njëjti bilanc përfundimtar, përveç të tjerash shërben edhe si bilanc fillestar gjatë vitit vijues. Quhet fillestar pasi që shërben për hapjen e kontove në vitin vijues. Hapja e kontove bëhet me regjistrim të rëndomtë të gjendjes të kontove të caktuara, duke i bartur nga bilanci i gjendjes. Kjo bartje bëhet nëpërmjet urdhërit për regjistrim dhe ditarit. Të gjitha pozicionet e aktivitetit të bilancit regjistrohen në anën e majtë të kontove të mjeteve, kurse të gjitha pozicionet nga pasiviteti të bilancit regjistrohen në anën e djathtë të kontove të burimeve. Nga ky parim përjashtime bëjnë disa konto korrigjuese, pozicionet e të cilave gjinden në aktivë por kanë saldo pasive.

Po qe se gjatë vitit afarist na lajmërohen lloje të reja të mjeteve, apo të burimeve të mjeteve të cilat në bilancin fillestar të gjendjes nuk kanë ekzistuar, për ato mjete dhe burime të mjeteve hapen konto të reja. Përveç këtyre kontove të mjeteve dhe burimeve, hapen edhe konto të cilat shërbejnë për të ndjekur shpenzimet, të dalat, të ardhurat, rezultatin financiar, furnizimet, shitjet, etj.

Në vazhdim do të paraqesim një bilanc të gjendjes që do të na shërbejë si ilustrim për hapjen e kontove në bazë të bilancit fillestar të gjendjes.

| AKTIVI | “Besa” SHPK | 31.12. 20__ | PASIVI |
|---------------|------------------------------------|--------------------|---------------|
| | BILANCI FILESTAR I GJENDJES | | |

| | | | | | |
|----|--------------------------|----------|----|----------------------------|----------|
| 1 | Objekte ndërtimore | 300,00 | 1. | Kapitali vetjak | 3.300,00 |
| 2. | Pajime | 4.400,00 | 2. | Kredi për mj. Kryesore | 1.700,00 |
| 3. | Xhirollogaria | 2.000,00 | 3. | Kredi për mjetet e. xhiros | 3.000,00 |
| 4. | Arka | 100,00 | 4. | Detyrime ndaj furnitorëve | 800,00 |
| 5. | Kërkesa nga blerësit | 700,00 | | | |
| 6. | Rezervat e materialeve | 300,00 | | GJITHSEJ | 8.800,00 |
| 7. | Rezer. e prodh. Në vijim | 600,00 | | | |
| 8. | Rezer.e prodh. të gatsh. | 400,00 | | | |
| | GJITHSEJ | 8.800,00 | | | |

Në bazë të këtij shembulli shkollor të Bilancit të gjendjes, hapja e kontove do të bëhet në këtë mënyrë:

+1. K-to Objektet ndërtimore -

1.Saldo 300,00

+ 2. K-to Pajime -

1.Saldo 4.400,00

+ 3. K-to Xhirollogaria -

1.Saldo 2.000,00

+ 4. K-to Arka -

1. Saldo 100,00

+ 5. K-to Kërkesat nga blerësit -

1.Saldo 700,00

+ 6. K-to Rezervat e materialeve -

1.Saldo 300,00

+ 7. K-to Rezervat e prodh. në vijim -

1. Saldo 600,00

+ 8. K-to Rzerat e prodh. te gatshme -

1. Saldo 400,00


Deri tani gjendjet (saldo) e bartura të aktivitetit të bilancit të gjendjes u regjistruan në anën e majtë pozitive (+) të kontove gjegjëse. Pozicionet pasive të këtij bilanci do të barten në anën e djathtë negative (-) të kontove të burimeve.

| | |
|--|--|
| + 9. K-to Kapitali vetjak - | + 10. K-to Kredi për mjete kryesore - |
| 1.Saldo 3.300,00 | 1.Saldo 1.700,00 |
| + 11. K-to Kredi për mjetet e xhiros - | + 12. K-to Detyrime ndaj furnitorëve - |
| 1. Saldo 3.000,00 | 1.Saldo 800,00 |

Nga shënimi i kontove të lartpërmendura vërehet shkurtesa K-to për konto dhe të cilën do ta përdorim edhe në të ardhmen si dhe shkurtesën S. për gjendjen fillestare (saldo).

4.7. LLOJET E KONTOVE

Ndarja e kontove mundëson njohjen më të mirë të kontabilitetit, si dhe mundëson njohjen e rolit të kontove të veçanta si dhe korospondimin në mes tyre. Në bazë të kriterëve të ndryshme ekzistojnë edhe ndarje të ndryshme të kontove, por ne do të përmendim këto lloje të kontove:



4.7.1 Kontot për mjete dhe kontot për burimet e mjeteve

Ky grup i kontove bënë pjesë në kontot e bilancit të gjendjes. Në bilancin e gjendjes ndarjet e zërave bilancore bëhen sipas asaj se a janë në pyetje mjetet apo burimet. Kontot e mjeteve si dhe kontot e burimeve e tregojnë gjendjen fillestare, rritjen, zvogëlimin si dhe gjendjen përfundimtare të mjeteve dhe burimeve në një subjekt. Në kontot e mjeteve, në anën e majtë, regjistrohet gjendja fillestare dhe rritja e mjeteve, ndërsa në anën e djathtë zvogëlimi i mjeteve. Si shembull e marrim K-ton ARKA.

| + | K-TO | ARKA | - |
|------------------|------|------|---------------------|
| Saldo fillestare | ↑ | 100 | Pagës (zvogëlim) 30 |
| Arkëtim (rritje) | ↑ | 20 | ↓ |

Tek kontot e burimeve gjendja fillestare dhe rritja e obligimeve regjistrohet në anën e djathtë. Në anën e majtë të tyre regjistrohet zvogëlimi i obligimeve. Si shembull do të marrim K-ton “Detyrimet (obligimet) ndaj furnitorëve për mjete qarkulluese (xhiruese)”.

| + | K-TO | DETYRIME NDAJ FURNITORËVE PËR MJETE (XHIRUESE) | - |
|-----------------------------|------|--|------------------------------|
| Zvogëlim (pagesa e kredisë) | ↓ | 2000 | Saldo fillestare 5.600 |
| | | | Rritje (kredi të reja) 4.400 |

4.7.2. Kontot aktive, kontot pasive dhe kontot aktivo-pasive

Tek kontot aktive - shuma e anës së majtë të kontove është më e madhe se shuma e anës së djathtë të kontove pra, debia është më e madhe se kredia. Pra, qarkullimi i anës së majtë gjithnjë është më i madh se qarkullimi i anës së djathtë, ose madje i njëjtë me qarkullimin e anës së djathtë . Tek kontot aktive saldoja përfundimtare çdo herë është në anën e majtë, andaj edhe thuhet se kontot aktive kanë çdo herë saldo aktive (pozitive). Kontot aktive janë ato konto ku regjistrohen mjetet e ndërmarrjes. Skema e kontove aktive do të ishte :

+ D. KONTOT AKTIVË K. -

| | |
|--------------------|-------------------|
| Gjendja fillestare | Zvogëlimet |
| Rritjet | Saldo për barazim |

Me qenë se totali i anës së majtë të kontove aktive është më i madh se totali i anës djathtë, ndryshimi në mes anës së majtë dhe të djathtë (saldoja) bartet në anën më të vogël, në anën “kredi” për hir të barazimit. Kontot aktive do t’i paraqesim me anë të një shembulli:

| + D | K-TO REZERVA TË MATERIALEVE | K - |
|---------------------|-----------------------------|------------------------|
| Saldo | 100 | Zvogëlim 30 |
| Rritje (furnizim) | 50 | |

Saldoja e kësaj kontoje prej 120 den. (150-30) është pozitive, pasi që rrjedhë nga shuma më e madhe e anës së majtë. Tek kontot aktive saldoja asnjë herë nuk mund të jetë pasive. Saldo pasive tek këto konto do te ishte absurde. Tek shembulli i lartpërmendur saldo pasive do te nënkuptonte dhënie më shumë e materialeve në prodhim se sa ka pasur në rezerva.

Kontot pasive - shuma e anës së djathtë është më e madhe se shuma e anës së majtë të kontove pra, kredia është më e madhe se debia. Pra, qarkullimi i anës së djathtë është gjithnjë më i madh se qarkullimi i anës së majtë, ose madje i barabartë me qarkullimin e anës së majtë. Kontot pasive çdo herë kanë saldo negative (kreditore).

Skema e kontove pasive duket kështu:

| | |
|----------------------|--------------------|
| + D KONTOT PASIVE | K - |
| Zvogëlimet | Gjendja fillestare |
| Saldo për barazim | Rritjet |

Me qenë se te kontot pasive totali i anës “kredi”, është më i madh se totali i anës “debi”, ndryshimi me rastin e mbylljes së kontos, bartet në anën më të vogël, në anën “debi” për hir të barazimit. Kontot pasivë do t’i paraqesim me anë të një shembulli:

| + D K-TO KREDI PËR MJETE QARKULLUESE (XHIROS) | | K- | |
|---|-------|----------------------------------|-------|
| Zvogëlim (Pages krediti) | 1.000 | Saldo fillestare | 3.200 |
| | | Rritje (marje e kredive te reja) | 800 |

Saldoja e kësaj kontoje 3.000 (4000-1000) është negative pasi që rrjedh nga shuma më e madhe e anës së djathtë.

Kontot aktivo-pasive - Saldoja e këtyre kontove rrjedh nga shuma më e madhe e anës së majtë, por edhe nga shuma më e madhe e anës së djathtë. Sipas kësaj saldoja tek këto kontu mund të kalojë nga ana e majtë (Debi) në të djathtë (kredi) si dhe e kundërta. Kontot aktivo-pasive mund të jenë p.sh. K-tot “Kërkesa nga blerësit” K-toja “Furnitorët” etj. K-toja “Kërkesa nga blerësit” në princip është aktive por, në qoftë se ndërmarrja do të pranonte avans (paradhënie) atëherë kjo konto do të jetë pasive. Në mënyrë analoge në qoftë se ndërmarrja e jonë ka paguar avans furnitorëve atëherë Kontoja Obligim ndaj furnitorëve do të jetë konto aktive, e cila në parim është konto pasive.

P.sh. saldo në K-ton “kërkesa nga blerësi” është 200.000,00 den , kurse saldo në K-ton “xhirollogaria” 350.000,00 den.

1. Sipas ekstraktit të bankës, blerësit kanë paguar 200.000,00 den. në emër të borxhit.
2. Blerësit kanë paguar 80.000,00 den nëpërmjet bankës në emër të paradhënies për prodhimet tona.

| + K-to KËRKESA NGA BLERËSIT - | | + D. K-to XHIROLLOGARIA | | K - | |
|-------------------------------|---------|-------------------------|---------|-----|---------|
| S. | 200.000 | 1. | 200.000 | S. | 350.000 |
| | | 2. | 80.000 | 1. | 200.000 |
| | | | | 2. | 80.000 |

Gjatë regjistrimit të parë (avans) K-oja Kërkesa nga blerësit është konto pasive, e gjatë regjistrimit të dytë e njëjta konto kalon në konto aktive.

4.7.3. Kontot sintetike dhe kontot analitike

Kontot sintetike janë konto të përbashkëta, konto grupore dhe ndryshe quhen edhe konto të ndërlikuara. Pastaj ato ndahen në konto analitike, apo të veçanta. Sipas kësaj kontot analitike janë pjesë të një tërësie dhe paraqesin evidentim veç e veç dhe janë pjesë të ndonjë kontoje sintetike. Varësisht nga lloji edhe nevojat e ndërmarrjes një konto sintetike mundë të ndahet në dy apo më shumë konto, e në disa raste në qindra konto analitike.

Shuma e vlerave të anës së majtë dhe të djathtë të një kontoje sintetike duhet t'i përgjigjet shumës së vlerave të anës së djathtë dhe të majtë të të gjitha kontove analitike, të cilat na paraqiten si pjesë të asaj kontoje sintetike. Në qoftë se nuk përputhet atëherë sigurisht kemi bërë ndonjë gabim të cilën duhet evituar.

Kontot analitike kanë si qëllim zbërthimin e informacionit të kontos sintetike, me qëllim që të sigurohet një informacion analitik i nevojshëm.

Skemën e kontove sintetike dhe analitike do ta ilustrojmë duke e bërë zbërthimin e K-tos “furnitori” si konto sintetike në konto analitike.

KONTO SINTETIKE

| | | |
|----------|------------|-----|
| +D. K-to | FURNITORËT | K - |
| | 5.000 | |

| | | | | |
|----------|---------------|----|--|---------------------------|
| +D. K-to | FURNITORI “A” | K- | | } <i>Kontot analitike</i> |
| 1500 | | | | |
| +K-to | FURNITORI “B” | - | | |
| 1000 | | | | |
| +K-to | FURNITORI “C” | - | | |
| 2.500 | | | | |

4.7.4. Kontot e plota dhe ato të korigjimit

Kontoja e plotë me saldon e saj tregon gjendjen e mjeteve ose burimeve të mjeteve. P.sh. K-to ARKA në anën e majtë janë të regjistruara, përveç gjendjes fillestare, edhe të gjitha arkëtimet e parave të gatshme, e në anën e djathtë të gjitha pagesat me para të gatshme pra, drejtpërsëdrejti tregon saldon, ndryshimin ndërmjet anës së majtë dhe të djathtë, gjendjen e parave të gatshme në arkë, gjegjësisht sa duhet të jetë gjendja e parave të gatshme në arkë.

| + D. | K-to | ARKA | K - |
|--------|------|------|--------|
| 24.000 | | | 22.000 |

Ndryshimi i qarkullimit të anës së majtë dhe të djathtë të K-tos Arka saldoja prej 2.000 den. drejtë për së drejti tregon se në K-ton Arka duhet të gjinden 2.000 den. Ndërkaq, kontot korigjuese korigjojnë vlerën e përfshirë në ndonjë konto tjetër. Të dy kontot përbëjnë tërësinë dhe të dyja së bashku tregojnë gjendjen. Rasti i tillë është me K-ton “Korigjimi i vlerës së mjeteve themelore” që korigjon vlerën e mjeteve kryesore (themelore), me K-ton “Korigjimi i vlerës së kërkesave kontestuese” i cili korigjon tërësinë në K-ton “Kërkesat kontestuese”, K-ton “Korigjimi i vlerës së materialit” që korigjon vlerën e rezervave të materialit, K-to “Korigjimi i vlerës së prodhimeve të gatshme” që korigjon vlerën e përfshirë në K-ton “Prodhimet e gatshme” etj.

| + K-to | MAKINAT | - | + K-to | ORRIGJIM I VLER. SË | - |
|-------------|---------|---|--------|---------------------|-------|
| | | | | METEVE KRYESORE | |
| Vlera furn. | 16.000 | | | Vlera e shlyer | 6.000 |

1. Nga kjo rrjedh se vlera furnizuese e makinave është 16.000 den. Me këtë vlerë është furnizuar makina dhe me këtë vlerë do të evidentohet gjersa është në përdorim. Pjesa e shpenzuar evidentohet në konto tjetër, K-to “Korigjimi i vlerës së makinës” për vitin përkatës.

2. Pjesa e pa harxhuar e makinës të shembullit të lartë përmendur përcaktohet duke e bartur saldon e kontos “Korrigjimi i vlerës së makinës” nga saldoja e kontos Makina.

4.7.5. Kontot e gjendjes, suksesit dhe të përziera

Kontot e gjendjes e tregojnë gjendjen e veçantë të mjeteve dhe burimeve në ditë të caktuar. Në kontot e gjendjes, së pari regjistrohet saldo-ja fillestare, e më pas të gjitha ndryshimet, që në fund të llogarisë periodike të mund të caktohet saldoja përfundimtare e në bazë të saldos fillestare të kontove të gjendjes sajohet bilanci i gjendjes.

Kontot e suksesit tregojnë efektin e punës pra, shërbejnë për përcaktimin e rezultatit financiar të subjektit. Kontot e suksesit janë konto të realizimit (shitjes) si dhe kontot e të hyrave dhe të dalave të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Të dalat paraqesin zvogëlimin e fondit afarist, zvogëlimin e pasivit dhe regjistrohet në anën e majtë të kontove përkatëse të të dalave. Në anën e djathtë të kësaj kontoje, regjistrohen vetëm korrigjimet e regjistrimeve të gabuara, zvogëlimi i më vonshëm i shumës së të dalave dhe saldoja për barazim.


| | | | |
|--------|------|-------------------|----|
| + D | K-to | Të dalat | K- |
| Rritja | | Zvogëlimi | |
| | | Saldo për barazim | |

Ndërkaq, të ardhurat rrisin fondin afarist dhe si të tilla regjistrohen në anën e djathtë të kontove përkatëse të të hyrave si dhe çdo rritje në pasivë. Në anën e majtë të K-tos e të hyrave gjinden korrigjimet e regjistrimeve të gabuara, zvogëlimi i mëvonshëm i shumës së të hyrave dhe saldoja për barazim.

| | | | |
|-------------------|------|-------------|---|
| + | K-to | Të ardhurat | - |
| Zvogëlim | | Rritja | |
| Saldo për barazim | | | |

Në literaturën e kontabilitetit hasen edhe të ashtuquajturat **kontot e përziera**. Tek këto konto në mënyrë direkte nuk mund të vërehet as gjendja e as sukcesi, për shkak se ato regjistrohen jashtë principit të kontabilitetit të dyfishtë.

Në vazhdim llojet e kontove do ti paraqesim në menyrë skematike:



4.8. SALDOJA E LLOGARIVE (KONTOVE)

Saldoja e llogarive (kotnove) paraqet ndryshimin e totalit të anës së majtë, pozitive (+) dhe anës së djathtë, negative (-) të kontove përkatëse në ditë të caktuar. Në literaturën dhe praktikën kontabël saldoja e kontove (llogarive) është sqaruar nga shumë aspekte të cilat mundë të përmblihen në dy grupe kryesore:

1. Saldo e kontove (llogarive) si kategori kontabël

2. Saldo e kontove (llogarive) si kategori ekonomike

Saldo e llogarive (kontove) si kategori kontabël është instrument kryesor për mbajtjen e evidencës kontabël në subjektet ekonomike dhe mund të definohet si gjendje fillestare, si dallim në mes shumës së anës së majtë, pozitive dhe shumës së anës së djathtë, negative të llogarisë gjegjëse. Saldoja po ashtu mund të definohet si mbetje, si gjendje dhe si rezultat i dy anëve të kundërta.

Saldot e llogarive, në evidencën kontabël të subjekteve ekonomike, së pari, shërbejnë për hapjen e librave në fillim të llogaris periodike për shkak se e përfaqësojnë gjendjen fillestare të llogarive përkatëse të mjeteve dhe burimeve të mjeteve të mjeteve.

Njohuritë mbi saldot e kontove të mjeteve dhe burimeve të mjeteve, si dhe saldot e kontove të të hyrave dhe të dalave, njohuritë funksionin e kontove dhe korospondencës së tyre në ndërrimet kontabël, mundësojnë zgjidhje të suksesshme të problemeve të rëndësishme jo vetëm nga aspekti tekniko-kontabël, por edhe nga aspekti qenësorë i kryerjes së funksionit të kontrollës në kuadër të një subjekti ekonomik.

| + | K-to | A R K A | - |
|---------|----------------|---------|----------------|
| 01. 05. | 250.000 | | 03.05. 80.000 |
| 04.05 | 30.000 | | 04.05 120.000 |
| 08.05. | 25.000 | | 08.05. 45.000 |
| 25.05 | 10.000 | | 31.05. 20.000 |
| | <u>315.000</u> | | <u>265.000</u> |
| | 50.000 | | |

Në pasqyrimin e kontos arka, është tërhekur një vijë e ndërprerë tek llogaria, e cila e ndjek transakcionin e fundit të evidentuar. Shuma e parave të arkëtuara është 315.000 denar, ndërsa shumat e pagesave të kryera është 265.000 denar. Shumat totale që ndryshe quhen **qarkullime** janë të evidentuara në formë të numrave me madhësi më të vogla se sa të zakonshmet dhe shënohen me një herë mbi vijën e ndërprerë dhe më më të majtë se sa vlerat e regjistruara. Ndryshimi i totalit të anës debi me anën kredi përcakton se kontoja arka me 31.05. ka saldo debi prej 50.000 denarësh (315.000 – 265.000).

Saldot normale sipas lloje të tyre në mënyrë të përmbledhur duken kështu:

| Lloji i kontos | + Debi Saldoja normale | Kredi Saldoja normale - |
|------------------------------|------------------------|-------------------------|
| Mjetet | Debi | - |
| Kaitali dhe detyrimet | - | Kredi |
| Të ardhurat | - | Kredi |
| Të dalat | Debi | - |

PYETJE

1 Çka janë ndërrimet (transaksionet) afariste e çka ato kontabë. Ku qëndron dallimi në mes tyre ?

2. Cili nga këto ndërrime (transaksione) janë objekt i regjistrimit kontabël dhe pse ?
3. Çka ndryshon në bilancin e gjendjes me anë të ndërrimeve kontabël?
4. Cilat janë ndërrime (transaksione) interne e cilat eksterne ?
5. Cilat janë katër ndërrimet (transaksionet) bilancore ?
6. Jep shembuj se si vjen gjer tek rritja e shumës së bilancit ?
7. Jep shembuj se si vjen gjer tek zvogëlimi i shumës së bilancit ?
8. Jep shembuj se si vjen gjer tek ndryshimi i strukturës së aktivitet tek bilanci i gjendjes
9. Jep shembuj se si vjen gjer tek ndryshimi i strukturës së pasivitet tek bilanci i gjendjes ?
10. Pse nuk përpilohet bilanc i gjendjes gjatë çdo ndërrimi?
11. Për çka përdoren kontot?
12. Çka nënkuptojmë me regjistrimin lëndë e çka me karakter?
16. Si karakterizohet rregulla e regjistrimit të kontove të mjeteve?
17. Si karakterizohet rregulla e regjistrimit të kontove të burimeve?
18. Çka është kontimi- regjistrimi?
19. Si sqarohet grupi i ndërrimeve ku mjetet e një kontoje rriten, ndërsa në konton tjetër të mjeteve zvogëlohen?
20. Si sqarohet grupi i ndërrimeve që shkaktojnë zvogëlimin e mjeteve të një kontoje dhe njëherit zvogëlim të obligimeve të një kontoje të burimeve?
21. Si sqarohen ndërrimet që shkaktojnë rritje të mjeteve të një kontoje dhe njëherit me rritjen e obligimeve të një kontoje të burimeve?
22. Si sqarohen ndërrimet që shkaktojnë rritje të detyrimeve të një kontoje të burimeve dhe njëkohësisht me zvogëlimin e ndonjë kontoje tjetër të burimeve?
23. Si bëhet hapja e kontove në bazë të bilancit të gjendjes?
24. Numëroi llojet e kontove?
25. Cilët janë elementet kryesore të kontos (llogarisë)?
26. Ku regjistrohet saldoja (gjendja), rritja dhe zvogëlimi tek:
 - a). Mjetet; b). Burimet e mjeteve; dhe c). Kapitali
27. Cilat janë hapat kryesore gjatë kontimit?

1. Formo 2 konto aktive dhe 2 konto pasive.
2. Formo dy konto sintetike dhe ato zbërthej në konto analitike.

USHTRIMI Nr.2

Cilat zëra bilancor (i gjendjes dhe i suksesit) kanë saldo normale debitore ose kreditore

| Emri i kontos | Rritet në debi | Rritet në kredi | Saldo normale |
|------------------------|----------------|-----------------|---------------|
| Mjetet - asetet | + | | + |
| Detyrimet | | | |
| Kapitali | | | |
| Të dalurat- shpenzimet | | | |
| Të ardhurat- arkëtimet | | | |

USHTRIMI Nr.2.

Gjatë muait Janar “Aida” Shpk ka bërë këto transaksione kontabël:

- 1.Pronari A.B. në xhirollogarin e “Aidës” për startim të biznesit investoi kapitalin financiar në vlerë prej 425.000 den.
- 2.Sipas raportit të arkës në kesh bleu materiale për zyrë në vlerë prej 11.500 den.
- 3.Sipas ekstraktit të bankës pranoi kredi nga Banka Ekonomike në vlerë prej 230.000 den.
- 4.Bleu objekt ndërtimore nga xhirollogaria në vlerë prej 150.500 den.
5. Sipas raportit të arkës pagoi shpenzimet e sigurimit në vlerë prej 10.200 den.
6. Sipas raportit të arkës kreu shërbime ndaj blerësve në kesh në vlerë prej 78.000 den.
7. Sipas ekstraktit të bankës pagoi detyrimet ndaj TVSH në vlerë prej 25.500 den.
8. Sipas faturës nr. 25 kreu shërbime ndaj blerësve në afat pagese në vlerë prej 76.000 den.

Nga ndërimet e lartëshënuara kërkohet:

- a). Tregoni llogaritë të cilat debitojnë dhe kreditojnë dhe saldot e tyre në gjendje normale.
- b). të pasqyrohen pretendimet dhe efektet.

-a- Loogarit që debitojnë dhe kreditojnë me saldot normale.

| Nd. | Konto Debi | S -D | S- K | Konto Kredi | S-D | S - K |
|-----|------------|------|------|-------------|-----|-------|
| | | | | | | |

| | | | | |
|---|---------------|---|---------------------|---|
| 1 | Xhirollogaria | + | Kapitali i pronarit | + |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |
| 5 | | | | |
| 6 | | | | |
| 7 | | | | |
| 8 | | | | |

-b). Pretendimet dhe efektet

| | Pretendimet | | |
|------------------|-------------|---|----------------------|
| | Mjetet | = | Detyrimet + Kapitali |
| 1. Efekti | 425.000 | | -425.000 |
| 2. | | | |
| 3. | | | |
| 4. | | | |
| 5. | | | |
| 6. | | | |
| 7. | | | |
| 8. | | | |
| | | | |

USHTRIMI 3.

Para kontos (llogarisë) shëno shkronjën D (debi) apo K (kredi) për kontot që kanë saldo normale debitore ose kreditore:

D Mjetet transportuese;

___ Llogarit e pagueshme;

___ Xhirollogaria;

___ Dëftesat e pagueshme;

___ Pajimet;

___ Detyrime ndaj rrogave;

___ Stoqet e mallit tregtar

___ Shpenzimet e rrymës;

___ Llogarit e arkëtueshme;

___ Kapitali i pronarit;

___ Të hyrat nga shitja;

___ Arka (keshi);

USHTRIMI 4.

Të tregohet se cila nga kontot e më poshtme është konto mjete, detyrimi, kapitali, të ardhura, apo të dala (shpenzimi).

___ Kapitali i pronarit; ___ Shpenzimet e pagave; ___ Detyrime ndaj furnitorëve (LLP);

___ Të ardhurat nga provizioni; ___ Stoqet e mallrave; ___ Pagat e papagura; ___ Kërkesat nga blerësit (LLA);